



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik N.N.SH. "VIZION PROJECT" të datës 17.07.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 11.07.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Hartimi i projekteve për ndërtim të ulët" me nr. të prokurimit 616-23-4727-2-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET si e bazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik N.N.SH. "VIZION PROJECT" e datës 17.07.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 11.07.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Hartimi i projekteve për ndërtim të ulët" me nr. të prokurimit 616-23-4727-2-1-1 ashtu që **ANULOHET** njoftimi mbi vendimin i datës 11.07.2023 i autoritetit kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në **RIVLERËSIM** aktivitetin e prokurimit nga pika I e këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik N.N.SH. "VIZION PROJECT" si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik N.N.SH. "VIZION PROJECT" (tutje "parashtruesi") me datë 17.07.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 11.07.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Hartimi i projekteve për ndërtim të ulët" me nr. të prokurimit 616-23-4727-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritore (*in meritum*) të kërkesës.

Faqe 1 nga 4

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000

Tel.: 038-200-40-111

Email: visar.sbehu@rks-gov.net

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Pretendimi i parë (1) - *“OE i rekomanduar për kontratë te paramasa – te rubrika çmimi i peshuar ka shënuar më shumë se dy numra pas presjes dhjetore”.*

Pretendimi i dytë (2) - *“OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmime jo normalisht të ulëta ndërsa këtë fakt e keni vërtetuar edhe vet ju si autoritet kontraktues pasi që të njëjtit i keni kërkuar sqarime shtesë. Sqarimet të cilat i ka dhënë OE i rekomanduar për kontratë nuk mund dhe nuk duhet të merren parasysh për faktin se kur analizohen çmimet me të cilat ka ofertuar i njëjti, kuptohet se sqarimet nuk janë fare bindëse. Pra ju si autoritet kontraktues nuk mund dhe nuk është dashur ti cilësoni si sqarim të mjaftueshëm për çmimet me të cilat ka ofertuar OE i rekomanduar për kontratë. I njëjti në sqarimin e dhënë në shumicën e rasteve vetëm e ka cekur se çmimet janë në përputhje me ekonominë e procesit dhe se çmime prej 0.01 euro për njësi nuk janë çmime jo normalisht të ulëta”.*

Për shkak të këtyre pretendimeve, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 52, 56, 59 dhe 61 të LPP, pastaj me nenin 18.3, 40.16 dhe 41.3 të RRPP si dhe me nenin 10 të UPP.

Lidhur me pretendimin e parë: fillimisht duhet cekur se përmes nenit 17 par. 17.11 të RRPP është përcaktuar se *“Çmimi i ofertuar lejohet që të shënohet me maksimum dy (2) numra pas pikës dhjetore. Nëse OE ofron çmim me më shumë se dy (2) numra pas pikës dhjetore, oferta e tillë do të konsiderohet e papërgjegjshme”.* Mbi këtë bazë edhe në formularin e paramasës – përshkrimit të çmimit është vendosur vërejtja për të gjithë tenderuesi ku po ashtu përcaktohet se *“Çmimi i ofertuar lejohet që të shënohet me maksimum dy (2) numra pas presës dhjetore. Çdo numër i shënuar pas numrit të dyte (2) nuk do të merret për bazë në llogaritje të vlerës së ofertës, oferta e tillë do të konsiderohet e pa përgjegjshme”.*

Nga administrimi i ofertës së tenderuesit të rekomanduar është gjetur se i njëjti në paramasën-përshkrimin e çmimit me të cilin ka ofertuar ndër të tjera në kolonën me titull *“çmimi i peshuar”* për të gjitha tipet – kategoritë ka vendosur çmime të cilët kanë më shumë se dy (2) numra pas presjes dhjetore përkatësisht ka vendosur çmime me nga katër (4) numra pas presjes dhjetore. Në këtë mënyrë është gjetur se **pretendimi i parë ankimor është i bazuar.**

Lidhur me pretendimin e dytë: me datë 04.07.2023 Komisioni Vlerësues ka dërguar te tenderuesi i rekomanduar *“Letër standarde e kërkesës për informata mbi tenderin jo normalisht të ulët”.* Tutje me datë 07.07.2023 tenderuesi i rekomanduar ka dorëzuar përgjigjen e tij lidhur me këtë kërkesë.

Në raportin e komisionit vlerësues lidhur me këtë fakt thuhet vetëm se *“Komisioni ka kërkuar sqarime për çmime jo normalisht të ulëta për OE 3D me pikë më së shumti dhe i njëjti ka dorëzuar sqarimet sipas kërkesës”.* Përveç kësaj fjalie, komisioni nuk ka ofruar asnjë sqarim shtesë lidhur me dyshimet për çmimet jo normalisht të ulëta të tenderuesit fitues.

Përmes nenit 41 par. 41.8 të RRPP përcaktohet se:

- *“Gjatë përcaktimit se nëse një tender është jo normalisht i ulet, Autoriteti kontraktues duhet të merr në konsideratë:*
 - a. ekonominë e procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit;*
 - b. çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur;*
 - c. çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose*
 - d. origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara”.*

Tutje përmes nenit 41 par. 41.9 thuhet po ashtu se:

- *“Përveç elementeve të tenderit të përcaktuara në nenin 41.8 të kësaj rregullore, Autoriteti kontraktues duhet të merr në konsideratë: a. elementet e tenderit përfshirë elementet e nëntotaleve për paga si dhe kompensimet, materialet, kostot fikse dhe profitet”.*

Sa i përket pikës së pretendimit të dytë se nuk është dashur të merret parasysh letra me sqarime që ka dërguar tenderuesi i rekomanduar lidhur me çmimet jo normalisht të ulëta, nuk është gjetur ndonjë argument për të mbështetur këtë pikë të pretendimit. Kjo pasi që Autoriteti Kontraktues mund të kërkoj dhe të vlerësoj sqarime shtesë nga tenderuesit në përputhje me LPP dhe legjislacionin sekondar në fuqi. Mirëpo sa i përket pikës tjetër të pretendimit të dytë se në këtë rast është ofertuar me çmime jonormalisht të ulëta, në raportin e komisionit vlerësues është gjetur se nuk janë bashkangjitur sqarimet që kërkohen sipas nenit 41 par. 41.8 dhe par. 41.9 të RRPP. Konkretisht kur komisioni e vlerëson një sqarim për çmime jonormalisht të ulëta, duhet të evidentoj edhe dëshmi bindëse se me rastin e vlerësimit të këtij sqarime ka marrë parasysh edhe kriteret nga dispozitat e RRPP të cituara më sipër. Megjithatë nga raporti i vlerësimit nuk është gjetur se komisioni ka vepruar në këtë mënyrë.

Prandaj është arritur përfundimi se pretendimi i dytë ankimor është i bazuar pjesërisht.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimin e tij të parë dhe pjesërisht pretendimin e tij të dytë. Në këtë mënyrë është gjetur se komisioni vlerësues nuk pra vepruar në përputhje me nenin 17 par. 17.11 të RRPP si dhe me nenin 41 par. 41.8 lidhur me par. 41.9 të RRPP. Për këto arsye është miratuar si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit.

Vlen të theksohet që sa i përket pikave të pretendimeve në raport me tenderuesit e tjerë të pasuksesshëm, të njëjtat nuk janë shqyrtuar me këtë vendim pasi që parashtruesi në raport me këto pretendime ankimore nuk është palë e interesuar në kuptim të nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP.

Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 24.07.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.